



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 56, Datë 20.02.2026

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E
TENSIONIT 20/10/6 KV PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 678/1 prot., datë 18.02.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2026” dhe informacionin shtesë me nr. 678/4 prot., datë 19.02.2026 “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe shoqëritë ujësjellës kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV për vitin 2026”,

Konstatohet se:

- Në përputhje me nenin 20 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE ka kompetencë të miratojë tarifat dhe çmimet e rregulluara për të licencuarit që ushtrojnë aktivitete në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me metodologjitë e miratuara prej tij.
- KESH sh.a. me datë 18.02.2026 dërgoi në ERE “Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 1212/1 prot., datë 06.02.2026 për vitin 2026”, i cili përcaktonte çmimin mesatar të shitjes së energjisë për sasinë e kontraktuar për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV (prej 12.00 lekë/kWh), për vitin 2026.,
 - FSHU sh.a me shkresën me nr. 678/3 prot., datë 19.02.2026, paraqiti aplikimin mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2026 për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit të lidhur në nivelin e tensionit 6/10/20 kV si dhe për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV, bashkëlidhur të cilit gjendej dhe “Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të KESH sh.a, nr.1212/1 prot., datë 06.02.2026”.
 - Në aplikimin e përcjellë, FSHU sh.a cilëson klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV si klientë të rëndësisë së veçantë ku kosto e blerjes së energjisë elektrike do të jetë 12.00 lekë/kWh.
 - Në “Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit” me nr. 1212/1 prot., datë 06.02.2026, evidentohet që kosto e blerjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit

të mundësisë së fundit do të jetë e aplikueshme për të gjithë klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV të cilët do të shërbejnë në kushtet e mundësisë së fundit do të jetë 12 lekë/kWh për të gjithë vitin 2026.

- Komponentët e përdorur për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:
 - **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBET)** për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV edhe për vitin 2026 do të vijojë të jetë 12.00 lekë/kWh, bazuar në vendimin e Asamblesë së përgjithshme të Aksionarit nr.1212/1 prot., datë 06.02.2026 të KESH sh.a.
 - **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 Janar 2025-31 Dhjetor 2027 e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.279, datë 16.12.2024, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025 - 31 dhjetor 2027” prej 0.85 lekë/kWh.
 - **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV**, në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”, është 3.99 lekë.
 - **Kostot administrative, të cilat vijnë të jenë** 1.06 lekë/kWh.
 - **Kthimi për riskun prej 3%** (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike) në vlerën 0.36 lekë/kWh për kategorinë e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.
- Në zbatim të ‘Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit’ dhe të dhënave në dispozicion në përllogaritjet e kryera nga ERE rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së fundit për vitin 2026, për klientët e rëndësisë së veçantë të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV paraqitet në tabelën në vijim:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2026			
		Njësia	Çmimi
ÇBET	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3 %)	Lekë/kWh	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	3.99
Çmimi i energjisë = ÇBET + Pr * ÇBET + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	18.26

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2026, prej 18.26 Lekë/kWh për klientët e rëndësisë së veçantë të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Çdo ndryshim në elementët përbërës të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë shoqërinë FSHU sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI